

RAPORT MBI BUXHETIMIN E PËRGJEGJSHËM GJINOR 2021-2023

1

1. Të dhëna për programin e përzgjedhur

Emri i programit:

Për krijimin e vendeve të reja të punës

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА,
ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE,
DEMOGRAFISË DHE RINISË - SHKUP
Бр. / Nr. 17-786/1
24-01-2025 20 / год. / viti

Sektori (njësia organizative) kompetente për zbatimin e programit:

Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lloji i programit

☒ **Horizontal**

☐ **Vertikal**

Si lidhet programi me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2022-2027:

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çështjet e barazisë gjinore nga aspekti legjislativ janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me ligj të veçantë, gjegjësisht me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat. Krahas kësaj, ekzistojnë një sërë dokumentesh strategjike për barazinë gjinore, si një angazhim i përgjithshëm për përfshirjen e perspektivës gjinore në ligje të tjera që rregullojnë fusha të ndryshme sociale, duke siguruar kështu një qasje sistematike në arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave.

Prioriteti kryesor në fushën e ekonomisë është aktivizimi i popullsisë femërore dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës. Ky prioritet zë një vend të lartë në Strategjinë për Barazinë Gjinore 2022-2027 dhe në strategji të tjera në nivel kombëtar që i referohen avancimit të ekonomisë dhe rritjes së punësimit.

Bazuar në Strategjinë për Barazi Gjinore 2022-2027 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 170/2022) në Planin Nacional të Veprimit për Barazi Gjinore 2022-2024 me implikime fiskale, në Qëllimin e përgjithshëm 2:

Përmirësimi i pozitës së gruas në të gjitha sferat e jetës publike dhe private dhe qëllimi specifik 2.1: Reduktimi i hendekut gjinor në pjesëmarrjen ekonomike të grave dhe në tregun e punës, me një qasje ndërsektoriale parashikon:

Zbatimin e aktiviteteve në terren (debate publike, takime informuese) për njohjen e grave nga zonat rurale me mundësitë e punësimit dhe stimulimin e shoqërimit të grave nga zonat rurale në kooperativa; Mbështetje financiare për sipërmarrjen femërore për digjitalizimin e proceseve të biznesit.

2. Hyrje

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, femrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë shkallë të ulët të pjesëmarrjes në tregun e punës që varion nga 45,1% në vitin 2021 deri në 42,8% në vitin 2023, që është nën mesataren globale prej 48.7% dhe mesataren e Bashkimit European prej 52.3%. Në krahasim, shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve është dukshëm më e lartë, duke filluar nga 66.8% në vitin 2021 deri në 62% në vitin 2023. (tabela 1)

Edhe pse punësimi varet drejtpërdrejt nga rritja dhe zhvillimi ekonomik, si përpjekje e veçantë për arritjen e punësimit më të madh, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton politika dhe masa aktive në tregun e punës.

Табела 1. Стапки на активност на населението по пол									
Normat e aktivitetit të popullsisë sipas grupmohave									
	Shkalla e aktivitetit			Shkalla e punësimit ¹⁾			Shkalla e papunësimit		
	2021	2002	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Gjithsej	55.8	55.2	52.3	47.2	47.3	45.4	15.4	14.4	13.1
meshkuj	66.8	66.3	62	55.7	55.9	53.2	16.6	15.7	14.3
femra	45.1	44.3	42.8	39.0	38.8	37.9	13.6	12.5	11.3

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave

Masat aktive në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut u prezantuan në vitin 2007, për të përballuar shkallën e lartë të papunësisë dhe inaktivitetit. Të njëjtat janë pjesë e planit vjetor Operativ për programet dhe masat aktive të punësimit (Plani Operativ) i krijuar nga Ministria për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini, ndërsa për zbatimin e tyre është përgjegjëse Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV).

Kryesisht, masat aktive ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Mbështetje për vetëpunësim
- Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës
- Trajnime
- Praktikë
- Programi i angazhimit në punë
- Ekonomia e kujdesit
- Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës përmes investimeve të gjelbra
- Pagesa e shtesës për të rinjtë
- Mundësia e dytë

Synimi i këtyre politikave dhe programeve është arritja e një norme më të lartë punësimi, reduktimi i varfërisë dhe aktiviteti ekonomik.

Të gjithë personat e regjistruar të papunë dhe punëdhënësit kanë qasje në programet, përkatësisht masat dhe shërbimet e punësimit. E drejta për pjesëmarrje përcaktohet në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara për çdo program individual, përkatësisht masës dhe shërbimit të punësimit, dhe si rregull i përgjithshëm, parimi i

përfaqësimit të barabartë sipas Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, si dhe pjesëmarrja e të rinjve, personave deri në 29 vjeç të paktën 30% në vitin 2022, ndërsa në 2023 të paktën 40%, secili prej programeve dhe masave dhe shërbimeve të punësimit.

Punëdhënësit që nuk kanë respektuar detyrimet nga kontratat e nënshkruara në vitet e mëparshme nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në programet dhe masat aktive nga vitet në vijim.

Kostoja totale e politikave të tregut të punës është më e lartë se mesatarja rajonale, por e ulët në raport me vendet krahasuese të BE-së. Në vitin 2018, Republika e Maqedonisë së Veriut nxori 0.43% të PBB-së së saj për politikën e tregut të punës, nga të cilat pak më shumë se një e treta është shpenzuar për masat dhe politikën aktive të punësimit (0.15% e PBB-së) dhe pothuajse gjysma për përfitimet e papunësisë (0.20% e PBB-së). Në vitin 2022, sipas Planit Operativ, janë ndarë burime financiare në masën 0.25% të PBB-së për programet dhe masat aktive të punësimit dhe rreth 0.18% janë realizuar për masat “pasive”.

3. Sfondi/konteksti

Mbështetja për krijimin e vendeve të reja të punës është një masë në Planin Operativ të Punësimit (që ekziston që nga viti 2017), qëllimi i të cilit është të inkurajojë punësimin e personave të papunë në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale (që synojnë kryesisht /qëllimet sociale dhe fitimet e të cilëve janë riinvestimet për arritjen e atyre qëllimeve, pra organizatave që ushtrojnë veprimtari ekonomike gjatë kryerjes së një veprimtarie) d.m.th. veprimtari e klasifikuar sipas te Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve me të cilin organizatat arrijnë qëllimet e tyre të përcaktuara nga statusi. Mbështetja e punësimit mund të jetë në formën e një subvencioni për pagën ose në formën e një granti për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve të reja. Kjo masë ka tre nën-masa dhe atë:

- Subvencionimi i pagave – masë për nxitjen e punësimit të një personi që është më vështirë për t'u bashkuar në tregun e punës; të rinjtë deri në 29 vjeç; më i vjetër se 50 vjet; personat e papunë të cilëve u është ndërprerë punësimi gjatë periudhës së koronavirusit COVID19; të kthyerit nga jashtë për shkak të krizës së shkaktuar nga Coronavirus COVID; personat përfitues të asistencës minimale të garantuar; përfituesit e përfitimeve monetare në bazë të papunësisë; personat që kishin statusin e fëmijëve pa prindër dhe perkujdesje prindërore; gra-viktima të dhunës me bazë gjinore dhe viktima të dhunës në familje; personat me aftësi të kufizuara; gra pjesëtare të bashkësisë etnike rome dhe bashkësisë të tjera etnike; personat që i përkasin komunitetit etnik rom; personat të cilëve nuk u është zgjidhur statusi me dokumente personale; prindër të vetëm; prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore; prindër të tre ose më shumë fëmijëve; prindërit e fëmijëve në rrugë, personat e dënuar pas lirimit nga institucioni penal; personat e pastrehë; personat me arsim të mesëm jo të plotë. Kjo masë ka për qëllim mbështetjen e punësimit të

personave të papunë që e kanë të vështirë të hyjnë në tregun e punës: të papunë afatgjatë mbi 12 muaj në evidencën e APRMV-së. Instrumentet financiare për masën përfshijnë një mbështetje financiare një herë e paguar për një periudhë 3, 6 ose 12 mujore, një pjesë e së cilës i referohet kostove të pagave dhe një pjesë e kostove të trajnimit të punonjësve të rinj me kohë të plotë. Shuma e mbështetjes është 19.000 denarë në muaj për një periudhë 3, 6 ose 12 mujore për punësimin e personave nga grupet e synuara. Punëdhënësi mund t'i paguajë punonjësit një pagë më të lartë;

- Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike - masë për mbështetjen e krijimit të vendeve të reja të punës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat civile. Mbështetja për punësim përmes punësimit dhe rritjes së subjekteve juridik përfshin mbështetjen për punësim të ri deri në 460.000 denarë, 768.750 denarë dhe 1.000.000 denarë (varësisht nga mosha dhe numri i punësimeve të miratuara). Shuma e grantit për punësimin e një personi mbi moshën 29 vjeçare është 92.000 denarë, për personat deri në 29 vjet, shuma e grantit për një person të punësuar është 153.750 denarë, ndërsa për personat përfitues të ndihmës minimale të garantuar dhe për personat e papunë nga bashkësia etnike rome, shuma e grantit për një person të punësuar është 200.000 denarë, ndërsa për personat e papunë që kanë humbur punën pas për shkak të pandemisë Covid 19 (nga marsi 2020), mbështetja financiare do të jetë 260.000 denarë.
- Mbështetja për punësimin e personave me aftësi të kufizuara - një përzierje masash për të inkurajuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara përmes subvencionimit të pagave, përshtatjes së vendit të punës dhe trajnimit të tyre në punë përmes trajnimit dhe mentorimit. Masa e mbështetjes për punësimin e personave me nevoja përfshin lloje të ndryshme të mbështetjes financiare, përkatësisht: punësimin e personave me nevoja në kohë të pacaktuar, për të cilin janë dhënë 20 paga mesatare neto të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak para punësimit, gjegjësisht 40 paga mesatare neto të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak para punësimit, nëse bëhet fjalë për një të verbër ose një person me nevoja që lëviz me ndihmën e një karrige me rrota; përshtatja e vendit të punës për të cilin janë ndarë mjete financiare deri në 100.000,00 denarë; dhe blerjen e pajisjeve për të cilat janë ndarë mjete në vlerë deri në 200 paga mesatare neto të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak, me kriter bazë për shumën e mjeteve të ndara numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar; dhe trajnimin për punë të personave me nevoja të punësuar dhe të papunësuar.
- **Pjesëmarrja në program dhe përzgjedhja e punëdhënësve** bëhet në përputhje me kriteret e mëposhtme:
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të përhershëm në ditën e aplikimit dhe para zbatimit të mbështetjes nuk duhet të jetë më i ulët se numri mesatar i punonjësve të përhershëm në vitin kalendarik të kaluar, përveç rasteve kur arsyet për uljen e numrit të të punësuarve janë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës (për shkak të dorëheqjes së punonjësit), ushtrimit të së

drejtës për pension, vdekjes ose paaftësisë për punë;

- Në ditën e aplikimit, janë rakorduar të gjitha detyrimet në bazë të pagave dhe kontributeve të paguara nga sigurimet e detyrueshme sociale;
- Të mos ketë humbje financiare në vitin paraprak, përveç nëse humbja është bërë për shkak të investimeve kapitale nga subjekti juridik;
- Punëdhënësi duhet të ketë të paktën një punonjës me afat të pacaktuar, me përjashtim të organizatave civile që mund të mos kenë punonjës në momentin e aplikimit;
- Numri i personave të sapo-punësuar që mund të marrë punëdhënësi përmes programit të mbështetjes së punësimit nuk mund të jetë më i madh se 50% e numrit mesatar të të punësuarve në vitin e kaluar kalendarik, ndërsa numri maksimal nuk mund të jetë më i madh se 5 persona në një punëdhënës në një vit kalendarik, me përjashtim të rasteve kur punësohen përfitues të asistencës minimale të garantuar ku numri maksimal i të punësuarve nuk kufizohet nga kjo masë.


Realizimi bëhet përmes thirrjes publike dhe procedura parasheh paraqitjen e aplikimit, procesin e përzgjedhjes, nënshkrimin e marrëveshjes së grantit për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve të reja ose punësimin dhe hapin e fundit, monitorimin ose ndjekjen e masës.

4. Rezultatet e arritura, ndryshimet dhe ndikimet (kushtet fillestare dhe treguesit që tregojnë ndryshimet që janë monitoruar)

Subvencionimi i pagave

Me masën e pagave të subvencionuara në vitin 2021, mbulimi i planifikuar i personave të papunë që janë më të vështirë për t'u bashkuar në tregun e punës ishte 1978 persona. Në vitin 2022, qëllimi i synuar i kësaj mase ishte 2508 persona të papunë, nga të cilët 790 persona nëpërmjet projektit IPA nga grupet e synuara: përfitues të asistencës minimale të garantuar, gra, të rinj deri në 29 vjeç, romë, persona me aftësi të kufizuara dhe të papunë afatgjatë (IPA II e katërta një grant direkt siguron 50% të shumës totale të subvencionit për 790 persona). Ndërsa në vitin 2023, shtrirja e të papunëve sipas kësaj mase ishte 2508 persona të papunë, nga të cilët 790 persona nëpërmjet projektit IPA nga grupet e synuara: përfituese të asistencës minimale të garantuar, gra, të rinj deri në 29 vjeç, romë, personat me aftësi të kufizuara dhe të papunët afatgjatë (Granti i katërt direkt IPA II siguron 50% të shumës totale të subvencionit për 790 persona).

1. Grafiku. Mbulimi i planifikuar i personave të papunë për masën e Subvencionimit të pagave




Në vitin 2021 janë lidhur 1406 kontrata me punëdhënës për punësimin e 1771 personave të papunë, nga të cilët 832 janë femra, 912 janë të rinj deri në 29 vjeç dhe 79 romë.

Në vitin 2022 janë lidhur 1228 kontrata me punëdhënës për punësimin e 1536 personave të papunë. Prej tyre 767 persona ishin gra, 719 persona të rinj nën moshën 29 vjeç dhe 69 persona romë. Në kuadër të projektit IPA “Aktivizimi i grupeve të cenuara në tregun e punës” sipas PO 2022, me këtë masë janë punësuar 124 persona, 70 gra, 79 të rinj deri në 29 vjeç dhe 9 persona romë.

Në vitin 2023 janë lidhur 1156 kontrata me punëdhënës për punësimin e 1360 personave të papunë. Prej tyre 777 persona ishin femra, 704 persona të rinj nën moshën 29 vjeç dhe 59 persona romë. (shih grafikun 2)

Grafiku 2. Kontratat me punëdhënësit, të punësuarit dhe gratë



Në periudhën e analizuar mund të konstatohet se kemi një rënie prej 18% në kontratat e nënshkruara me punëdhënësit, një rënie prej 15% në punësimin e grave dhe punësimin e të rinjve me 23% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2021.

Sipas të dhënave administrative të APRMV, grupet e synuara më të përfaqësuara janë: të rinjtë deri në 29 vjeç, moshat 30-49 vjeç, moshat 50 vjeç e lart, personat me arsim fillor, të papunët afatgjatë (më shumë se 12 muaj në rekord, me avantazh të personave të papunë, gratë që i përkasin komunitetit etnik rom, etj.

Punësimi dhe rritja e subjekteve juridik

Në vitin 2021, numri i planifikuar i pjesëmarrësve është 353 persona të papunë. Gjatë vitit 2021 janë publikuar dy thirrje publike në të cilat kanë aplikuar 448 punëdhënës për 628 vende pune. Më 31 dhjetor 2021 ishin të punësuar 247 persona, nga të cilët 118 gra, 151 të rinj deri në moshën 29 vjeç, 22 romë dhe 7 përfitues të asistencës minimale të garantuar.


Gjatë vitit 2022, në thirrjen publike kanë aplikuar 715 punëdhënës për 899 vende pune. Pas përzgjedhjes së bërë nga Komisioni për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në programet dhe masat aktive të punësimit, janë lidhur 355 kontrata me punëdhënës për punësimin e 446 personave të papunë. Prej tyre 251 persona ishin gra, 231 persona të rinj nën moshën 29 vjeç dhe 33 persona romë.

Për vitin 2023, numri i planifikuar i pjesëmarrësve ishte 536 persona të papunë. Gjatë vitit 2023, në thirrjen publike kanë aplikuar 731 punëdhënës për 954 punësime. Pas përzgjedhjes së bërë nga Komisioni për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në programet dhe masat aktive të punësimit, janë lidhur 420 kontrata me punëdhënës për punësimin e 545 personave të papunë. Prej tyre 278 persona ishin gra, 325 persona të rinj nën moshën 29 vjeç dhe 148 romë.

Nëpërmjet kësaj mase, në periudhën e analizuar janë punësuar 1238 të papunë, nga të cilët 647 femra, 707 të rinj deri në 29 vjeç dhe 303 romë.

Ajo që mund të konstatohet nga të dhënat nga Raportet e Planit Operativ për masat e punësimit është se numri i të punësuarve në vitin 2023 është rritur për 54% krahasuar me vitin 2021, si dhe numri i femrave për 57%.

Grafik 3. Numri i të punësuarve përmes masës Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike



Mbështetje për punësimin e personave me nevoja

Gjatë vitit 2021, APRMV ka pranuar 181 kërkesa për ndarje të mjeteve të pakthyeshme nga Fondi i Posaçëm, nga të cilat 117 kërkesa për punësim të 167 personave me invaliditet për një periudhë të pacaktuar, 63 kërkesa për blerje pajisjesh dhe 1 kërkesë për përshtatje në një vend pune ku punojnë persona invalidë.

Sipas evidencës financiare për vitin 2021 janë realizuar mjete në vlerë të përgjithshme

prej 173.248.121 denarë për:

- punësimi i 157 personave invalid (113 kërkesa), janë paguar mjete në vlerë prej 76.129.820 denarë;
- blerja e pajisjeve për 57 kërkesa, janë paguar mjete në vlerë prej 97.054.301 denarë;
- përshtatja e vendit të punës për 1 kërkesë, janë paguar mjete në vlerë prej 100.000 denarë;

Ndërsa në vitin 2022 në APRMV janë dorëzuar 152 kërkesa për dhënie të mjeteve të pakthyeshme nga Fondi special, nga të cilat 112 kërkesa për punësim të 153 personave me invaliditet me afat të pacaktuar, 37 kërkesa për blerje pajisjesh dhe 3 kërkesa për përshtatje në vendin e punës ku punojnë personat me invaliditet.

Sipas evidencës financiare për vitin 2022 janë realizuar mjete në vlerë të përgjithshme prej 133.323.519 denarë për:

- punësimi i 137 personave invalid (95 kërkesa), janë paguar mjete në vlerë prej 73.270.520 denarë;
- prokurimi i pajisjeve për 41 kërkesa, janë paguar mjete në vlerë prej 59.852.999 denarë;
- përshtatja e vendit të punës për 2 kërkesa, janë paguar mjete në vlerë prej 200.000 denarë.

Gjatë vitit 2023, në APRMV janë dorëzuar 139 kërkesa për dhënie të mjeteve të pakthyeshme nga Fondi i Posaçëm, nga të cilat 97 kërkesa për punësim të 140 personave invalid me afat të pacaktuar, 41 kërkesa në bazë të blerjes së dhe 1 kërkesë për përshtatje në vendin e punës ku punojnë personat invalid. Nuk është paraqitur asnjë kërkesë për asistent pune për një person me invaliditet që është i përfshirë në trajnime për punë, me kërkesë të tij ose me kërkesë të punëdhënësit. Sipas evidencës financiare për vitin 2023 janë realizuar mjete në vlerë të përgjithshme prej 146.860.794 denarë, përkatësisht për:

- punësimi i 130 personave invalid (96 kërkesa), janë paguar mjete në vlerë prej 72.771.500 denarë;
- prokurimi i pajisjeve për 39 kërkesa, janë paguar mjete në vlerë prej 73.989.294 denarë;
- përshtatja e vendit të punës për 1 kërkesë, janë paguar mjete në vlerë prej 100.000 denarë.

Në periudhën e analizuar mund të konstatojmë se kemi një ulje të punësimit të personave invalid, si dhe në burimet financiare të kësaj nënmase.

Gjatë tre viteve të analizuara, numri i përgjithshëm i të punësuarve përmes masës Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës është 6.474 persona të papunë të regjistruar në APRMV.

Në kuadër të zbatimit të shërbimeve nga Plani Operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, në vitin 2023 janë ofruar gjithsej 57.590 shërbime për persona të papunë: për femra – 27.779 (48%).

Në periudhën raportuese kemi një rritje të pjesëmarrjes së grave të papuna në

programet dhe masat e Planit Operativ të Punësimit, ku në vitin 2021 është 44.2%, në vitin 2022 është 45.4%, ndërsa në vitin 2023 është 46%.

5. Analiza e alokimeve buxhetore (fondet e planifikuara dhe të shpenzuara, për përfitues, mjete shtesë, shpenzime specifike për gratë)

Në analizën e alokimeve buxhetore, mund të udhëhiqeni nga:

Analiza e mjeteve të shpenzuara në lidhje me treguesit e caktuar për atë program;

Shpërndarja në përqindje e shpenzimeve të burrave dhe grave;

Analizë e efekteve dhe ndikimit në arritjen e treguesve të programeve të destinuara posaçërisht për një kategori të caktuar qytetarësh, burra apo gra.

Në periudhën e analizuar, buxheti për zbatimin e masave nga plani operativ, burimet financiare janë në rritje, si dhe mbulimi i të papunëve. Buxheti i planifikuar për zbatimin e masave nga Planit Operativ në vitin 2023 rritet me 13.6% krahasuar me vitin 2021. Norma e realizimit të buxhetit financiar varion nga 84.4% në vitin 2021 në 76.4% në vitin 2023.

Nga të dhënat e shfaqura të Raporteve Vjetore, mund të konstatohet se për masën Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës, burimet financiare janë ulur me 18.2% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2021. (shih tabelën).

Tabela 2. Shfaqja e mjeteve të planifikuara dhe të lëshuara të Planit Operativ për vitet 2021, 2022 dhe 2023

	2021	2022	2023
Buxheti i planifikuar i PO	1.801.677.152	1.787.000.000	1.966.946.323
Mjetet e realizuara për PO	1.528.127.866	1.553.325.360	1.788.780.000
Buxheti i planifikuar i masës Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës	756.841.580	715.769.453	614.282.755
Buxheti i planifikuar i nënmasës Paga të subvencionuara	443.574.080	489.541.400	181.419.324
Mjetet e realizuara të nënmasës Paga të subvencionuara	390.165.000	356.286.000	74.614.000
Buxheti i planifikuar i nënmasës Punësimi dhe rritja e personave juridikë	49.967.500	109.018.250	107.200.000
Mjetet e realizuara të nënmasës Punësimi dhe rritja e subjekteve juridikë	45.590.000	71.187.105	89.642.000
Buxheti i planifikuar i nënmasës Mbështetje për punësimin e personave me nevoja	189.500.000	175.000.000	339.000.000
Mjetet e realizuara të nënmasës Mbështetje për punësimin e personave me nevoja	156.929.793	133.323.519	123.987.501

6. Grykat e ngushta dhe mësimet e nxjerra (Si mund ta përmirësojmë politikën/programin në të ardhmen për të siguruar rezultate më të mira sipas treguesve të përcaktuar)

Për të rritur përqindjen e femrave aplikante dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të të punësuarve, është e nevojshme ndërgjegjësimi i grave për përfitimet që ofrohen, angazhimi më i madh i komunave dhe koordinatorëve për mundësi të barabarta në njësitë e vetëqeverisjes lokale në lidhje me informimin dhe promovimin e politikave aktive të punësimit në komunitetet lokale.

7. Konkluzione dhe rekomandime

Nga analiza e rezultateve të zbatimit të masës Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës, mund të konstatojmë se është e suksesshme në vazhdimësi për sa i përket interesit të shfaqur nga personat e papunë dhe punëdhënësit e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, numri i aplikimeve të dorëzuara dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve, dhe e njëjta duhet të vazhdojë të zbatohet edhe në vitet në vijim.

Gjegjësisht, sipas analizës së masës sipas grupeve të synuara, tregojnë se në periudhën e analizuar, më të përfaqësuara janë gratë e papuna, të rinjtë deri në 29 vjeç, personat mbi 50 vjeç, personat me arsim të mesëm të paplotë ose të ulët, prindër me 3 ose më shumë fëmijë.

Analiza tregon se kjo masë është e përgjegjshme gjinore, por rekomandimet kanë për qëllim:

- Promovimi i masave për gratë përfituese të asistencës minimale të garantuar, viktimat të dhunës me bazë gjinore, gratë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, gratë romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike përmes bashkëpunimit të Qendrave për Punë Sociale dhe Qendrave të Punësimit në nivel lokal;
- Trajnimi i punëdhënësve që do të punësojnë gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore, vendosja e orarit fleksibël të punës në vendet e punës, etj. mungon një vizion i qartë për përfshirjen e tyre;
- Për masën Mbështetje për hapjen e vendeve të reja të punës, nuk ka statistika për monitorimin e situatës së punësimit pas kalimit të afatit të caktuar, pra pas përfundimit të detyrimit të punëdhënësit. Kjo masë duhet të sigurojë punësim afatgjatë që do të kontribuojë në pavarësinë dhe pavarësinë ekonomike të kategorive të ndryshme të cenueshme që janë të mbuluara. Përndryshe, masa nuk është efektive dhe duhet të rishikohet për të arritur qëllimin, që është ulja e papunësisë dhe varfërisë;
- Avancimi i informimit dhe promovimi i politikave aktive të punësimit në bashkësitë lokale të mesme rurale përmes angazhimit të komunave dhe koordinatorëve për mundësi të barabarta në vetëqeverisjen lokale;
- Mbështetje mentoruese nga Qendrat e Punësimit në tejkalimin e barrierave dhe sfidave të ndryshme gjatë aplikimit për gratë – përfituese të të ardhurave minimale të garantuara, gratë romë, pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike dhe

gra me invaliditet.

- Në raportet vjetore duhet të ketë të dhëna të ndara sipas gjinisë sipas kategorive: arsimi, sipas rajoneve planifikuese, sipas kombësisë, sipas grupeve të synuara, sipas shumës së pagave të subvencionuara, kohëzgjatjes së subvencionit, informacione për firma, etj.

Përpiloi: mr. Gabriella Maxhoska, Udhëheqëse njësie

Përktheu: Elmedina Selmani

Kontrollloi: Svetlana Cvetkovska, Udhëheqëse sektori

Miratoi: Jasmina Ivanova, Këshilltare shtetërore

Pajtohet: Fatmir Sabriu, Sekretar Shtetëror



Ministri,
Fatmir Limani

Fatmir Sabriu